

Për komente, sugjerime apo pyetje na kontaktoni në [info@pinkembassy.al](mailto:info@pinkembassy.al). Për më shumë vizitoni [www.pinkembassy.al](http://www.pinkembassy.al)

"Pink Embassy" ka nisur të zbato- het në Shqipëri përmes një partner- iteti mes organizatave COC Nether-

land, CRCA dhe LGBT PRO Shqipëri, me mbështetjen financiare të Programit të Transformimit Social (MATRA) të Ministrisë së Jashtme të Hollandës.

"Pink Embassy" synon të bëjë të mundur që në shoqërinë shqiptare në zhvillim, pozicioni, të drejtat dhe nevojat e komunitetit të lezbikeve, gejeve, biseksualëve, transeksualëve (LGBT) dhe personave ende të paqartë për orientimin e tyre seksual të respektohen plotësisht dhe që nevojat dhe shqetësimet e tyre të adresohen në mënyrën e duhur.

"Pink Embassy" synon të jetë një instrument i dhe për komunitetin LGBT në Shqipëri. PINK Embassy përdor ekspertizën, rrjetet dhe burimet e saj dhe të organizatave partnere zbatuese të këtij Programi për të përmirësuar situatën e këtij komuniteti në Shqipëri, duke advokuar e lobuar pranë të gjithë institucioneve shtetërore dhe jo shtetërore që kanë rol në drejtim të respektimit të të drejtave të këtij komuniteti duke u bërë kështu zë i hapur publik i komunitetit LGBT, si dhe duke punuar me këtë që ai vetë të arrijë kapacitetin për të formuluar kërkesat dhe shqetësimet e tij dhe për ti adresuar ato pranë institucioneve përkatëse.

I gjithë veprimi i PINK Embassy do të synojë përmirësimin e qëndrimit dhe shqetësimeve të shoqërisë shqiptare në drejtim të in dividëve dhe çështjeve të komunitetit LGBT, si dhe integritet të plotë të këtij komuniteti në jetën shoqërore, ekonomike, politike dhe sociale në Shqipëri.

## MANIFESTI PËR TË DREJTAT E KOMUNITETIT LGBT NË SHQIPËRI!

Faqe 10



### I vihat zjarr godinës ku banonin transgjjinorët.

Mendohet të jetë krim urrejtje. *faqe 2*



### Një komisioner për mbrojtjen nga diskriminimi.

Tashmë ankesat do të kenë një zyrë. *faqe 3*



### Leksion në Fakultetin e Shkencave Sociale

Dita kundër homofobisë... koha për sensibilizim. *faqe 4*



### Pritshmëri monogame

Historia personale e një djali nga Stambolli... *faqe 6*

# DEKLARATË E AMBASADES PINK DHE LGBT PRO ALBANIA

AMBASADA PINK, një organizatë që punon për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBT në Shqipëri, kërkon të shprehë shqetësimin e saj për ngjarjen e ndodhur në mëngjesin e datës 27 Prill 2011, kur jeta e pesë transgjnjorëve u vendos seriozisht në rrezik për shkak se shtëpisë ku ata qëndronin i është vënë zjarri nga persona ende të panjohur.

Të pesë trans-gjinorët ishin strehuar në një shtëpi të braktisur në Rrugën e Durrësit, ngjitur me ndërtesën e ish-ambasadës Jugosllave në Tiranë. Rreth orës 04.30 të mëngjesit, ata janë ngritur të alarmuar nga tymi dhe flakët, të cilat kishin bllokuar thujse të gjitha hyrjedaljet e shtëpisë. Po në këtë shtëpi jetonte edhe një familje e komunitetit rom me shtatë anëtarë, ku pesë prej të cilëve janë të mitur. Ndonëse fatmirësisht nuk ka pasur viktime, pjesëtarët e komunitetit transgjnjor, besojnë se akti vandal është kryer nga një grup homofobësh, të cilët duhet ta kenë identifikuar më parë vendodhjen e tyre.

Në vendngjarje kanë mbërritur menjëherë zjarrfikëset dhe forcat e policisë, që kanë mundur shuarjen e zjarrit dhe dhënien e ndihmës së parë. Sidoqoftë, Policia e Tiranës deri në momentin e përgatitjes së kësaj deklaratë, nuk ka bërë ndonjë komunikatë për shtyp në lidhje me këtë ngjarje, gjë që ngre dyshime serioze për trajtimin dhe barazinë midis shtetasve në vend.

Krimet e urrejtës ndëshkohen rëndë në të gjithë botën e civilizuar dhe Shqipëria nuk mund të bëjë përjashtim nga kjo. Ngjarja në fjalë tregon edhe një herë se, ndonëse Shqipëria ka miratuar Ligjin kundër Diskriminimit, jeta dhe dinjiteti i komunitetit transgjnjor vazhdon të nëpërkëmbet dhe vihet në rrezik.

Fakti që komunitetit transgjnjor, as Bashkia e Tiranës dhe as Ministria e



(Godina ku banonin transgjnjorët)

Punës, Çështjeve Sociale e Shanseve të Barabarta, nuk i kanë ofruar asnjë mundësi strehimi, sigurie dhe punësimi, tregon se homofobia është e ngulitur në mendësinë e sotme. Kjo për ne është e papranueshme! Jeta dhe dinjiteti i transgjnjorëve është i njëjtë me jetën dhe dinjitetin e çdo qytetari shqiptar!

Duke marrë shkas nga kjo ngjarje, ne i bëjmë thirrje Bashkisë së Tiranës dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale e Shanseve të Barabarta, që të reagojnë përballë këtij akti dhe t'i mundësojnë komunitetit transgjnjor plotësimin sa më të shpejtë të të drejtave të tyre minimale për siguri, strehim dhe ushqim. Këto të drejta presin një përgjigje urgjente ndaj ne kërkojmë marrjen e veprimeve të menjëhershme nga ana e institucioneve publike shqiptare.

Episodet e tilla, dëmtojnë jetën e komunitetit në veçanti dhe shoqërinë në përgjithësi, pasi të drejtat e njeriut janë të drejta të barabarta për këdo.

Ambasada PINK

# TAKIM ME KOMISIONEREN PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI



(Znj. IRMA BARAKU gjate takimit ne mjediset e Ambasades PINK)

komunitetin për mënyren sesi mund të drejtohen tek Komisioneri. Ankesa mund të bëhet nga vetë personi që pretendon diskriminim ose përmes një organizate. Institucioni garanton ruajtjen e anonimitetit të ankuesit. Struktura e parë pritëse është Zyra e Marrëdhënieve me Publikun, e cila pasi merr rastin e paraqitur, bën diferencën mes atyre që mund të pranohen ose jo, dhe orienton subjektin ku të shkojë nëse është çështje që do merret në shqyrtim nga Komisioneri.

Subjekti që pretendon diskriminim duhet të paraqesë disa fakte dhe informacione. Pas kësaj kërkohet informacion edhe nga subjekti diskriminues. Të dy vihen përballë Komisioneres. Pas kësaj merret vendimi, që personit të diskriminuar ti kthehet e drejta. Sanksioni, pra gjoba që vihet nga komisionerja shkon në buxhetin e Shtetit dhe jo tek personi që pretendon diskriminim.

Komisionerja tregon se

institucioni ka faqen e vet të internetit dhe ankesa mund të bëhet edhe online ose mund të printohet, të plotësohet nga personi që pretendon diskriminimin dhe të dërgoheet pranë zyrave të Komisioneres. Komisionerja ka bashkëpunime edhe me pushtetin vendor të disa prej qyteteve kryesore të vendit dhe përcakton një ditë për mbledhjen e ankesave nga qytetarët e këtyre zonave, nëse ka. Gjithashtu janë realizuar dhe parashikuar emisione në TV lokale për ndërgjegjësimin e qytetarëve si edhe takime të hapura me pushtetin lokal për pritjen e ankesave.

Komisionerja ka deklaruar se deri tani ka pasur 2 ankesa, një nga Ambasada Pink dhe një nga Nikoleta (pjesëtare e komunitetit transgjinnor) në Tiranë. Si një nga vështirësitë e punës së Komisionerit, ajo përmend vështirësinë në marrjen e informacionit nga institucionet shtetërore dhe pavarësisht nga afatet kohore, sipas saj, s'ndëryn dot lehtë. Sipas saj problemi qëndron në zbatimin e ligjit.

Komisionerja për Mbrojtjen Kundër Diskriminimit Znj. Irma Baraku së fundmi prezantoi misionin e punës së komisionit dhe prioritetin e këtij institucioni, që ka të bëjë me ndërgjegjësimin e organeve shtetërore, shkollave dhe gjithë qytetarëve në lidhje me mundësinë që ofron ligji për mosdiskriminimin. Pjesë e grupeve të synuara është edhe komuniteti LGBT.

Ajo informoi

Instituti mund ti rekomandojë Bashkisë së Tiranës ngritjen e një strehe për komunitetin transgjinnor në Tiranë, por nëse më parë ne bëjmë kërkesë te komisionerja për bërjen e rekomandimit.

Në fund të takimit u ra dakort që: Komisionerja të rekomandojë një program trajnimi për forcat e policisë përsa i përket mosdiskriminimit dhe respektimit të të drejtave. Komisionerja të ndikojë në Grupin e Punës Ndërinstitucionale për respektimin e të drejtave të komunitetit LGBT dhe veçanërisht për zgjidhjen e problemeve të transgjinnorëve (*strehë, punësim, mbrojtje*). Komisionerja në bashkëpunim me Pink të ndikojë dhe kërkojë nga institucionet respektimin e të drejtave të LGBT. Pink të çojë te komisionerja çdo kërkesë dhe ankesë të paraqitur.



## Leksion i hapur në Fakultetin e Shkencave Sociale

Më 17 Maj, në orën 9<sup>00</sup>, në kuadër të ditës ndërkombëtare kundër homofobisë, në Fakultetin e Shkencave Sociale u zhvillua një leksion i hapur me temë "Homofobia". Të pranishëm në leksion ishin rreth 200 studentë të po këtij fakulteti. Fillimisht, për të bërë një hapje, të pranishmeve ju bë një prezantim i Pink Embassy dhe ju shpjegua se çfarë është 17 Maj.

Siç shumë e dinë, por akoma më shumë jo, më 17 Maj 1990 homoseksualiteti është hequr nga lista



e çrregullimeve mendore nga Organizata Ndërkombëtare e Shëndetit. Pëshpërimat dhe të qeshurat nuk mungonin...

Në vazhdim u shpjegua diversiteti seksual dhe identiteti gjinor, çështje tejet të keqkuptuara nga opinion i gjërë. Leksioni i mbajtur nga vetë stafi i Pink Embassy kishte si qëllim të anonte më shumë në formë bashkëbisedimi sesa në leksion, por kur u pyet "A ka njeri ndonjë pyetje?" të gjithë heshtën. A thua të jetë akoma tabu kjo temë në shoqërinë shqiptare? Fatmirësisht kjo situatë nuk zgjati



shumë, kurjoziteti vrau macen thonë. Midis pyetjeve të tipit "Si mund t'a dalloj unë një lezbike?" dhe "A i ktheni njerzit në gay ne shoqatën tuaj?" vumë re se mungesa e informacionit ishte e jashtëzakonshme.

Në një moment skenën e rrëmbeu Ambasadorja vizituese Merita Pone, petagoge në Fakultetin e Shkencave Sociale. Do të doja vetëm të citoja një shprehje që ajo tha: "Natyra na dha lule, dhe njeriu çfarë krijoi me to? Bomba!

Momentalisht Pink Embassy po bënë një sërë leksionesh të këtilla jo vetëm në Fakultetin e Shkencave Sociale por edhe në Universitete private me degë të tilla. Por çfarë ndodh me pjesën tjetër të shoqërisë që nuk zotëron informacionin e duhur?!



# QESH BASHKË ME NE, JO ME NE!

**"Laugh with us, not at us"** është shprehje e cila ka buruar nga eksperiencat personale të komunitetit LGBT në Sermugnano, fshat në Italinë qendrore. Këto eksperiencat u bënë shkak që organizata nga vende të ndryshme të Evropës, ku ndër to edhe Shqipëria, të merrnin iniciativën për të zhvilluar një shkëmbim rinor në luftën kundër homofobisë.

Për 8 ditë, të rinj pjesëmarrës arritën jo vetëm të identifikojnë homofobinë si një problem të pranishëm në mbarë shoqërinë europiane por edhe të mësojnë sesi të aktivizojnë energjitë e tyre në të ardhmen për të punuar për vete dhe në luftën kundër homofobisë.

Në këtë trajnim morën pjesë 26 të rinj nga Spanja, Lituania, Hungaria, Italia, Franca dhe Shqipëria. Qëllimi kryesor ishte përballja me temën e homoseksualitetit pa bërë shumë "lojëra fjalësh", pa devijuar nga thelbi i temës e në kërkim të rindërtimit të një rruge jo paragjyqese.

Nisur nga nevoja e madhe që ekziston për të kapërcyer stereotipet rreth temës së homoseksualitetit dhe

diskriminimit, gjatë këtij aktiviteti, u simulua përjetimi i një eksperience rritjeje dhe identifikimi, duke u përballur edhe me problematika të tilla si dhuna, legjislacioni dhe paragjykimet. Edukimi jo formal ishte metoda e përdorur gjatë gjithë aktivitetit. Pjesëmarrësit patën mundësi të eksploronin fillimisht forma të ndryshme diskriminimi që mund të ndodhin gjatë jetës së përditshme, ku pikasi diskriminimi ndaj roleve gjinore. Mendimet e shfaqura nga pjesëmarrësit ishin të larmishme dhe herë-herë kontradiktore, gjë që e bëri debatin shumë konstruktiv dhe ndihmoi pjesëmarrësit të kuptojnë më mirë shkaqet, sjelljet, qëndrimet dhe mendimet e njerëzve gjatë procesit të diskriminimit.

Mendime dhe eksperiencat të ndryshme u kryqëzuan, nga vetë fakti që pjesëmarrësit vinin nga kultura të ndryshme. Po të shihej në një këndvështrim gjeografik homofobia kishte shfaqje më të zbehta në vende si Spanja dhe Franca, dhe një intensitet më të lartë në vendet si Italia, Hungaria, Lituania dhe Shqipëria.

Sesionet vijuan me lojëra

simulimi rreth tolerancës, të qenit në vendin e tjetrit, sesione të dedikuara legjislacioneve dhe aktivizimit për të drejtat e komunitetit LGBT.

Një nga pikat kulmore të aktivitetit ishte kur i ftuari special, Giacomo Guçinelli - koordinator i ARCIGAY organizata më e rëndësishme LGBT në Itali - mbajti një workshop rreth termave të seksualitetit, duke filluar nga niveli biologjik i të qenit mashkull ose femër, e duke përfunduar tek qenia seksuale komplekse njerëzore në të gjitha format dhe trajtat e saj. Ky sesion ndihmoi pjesëmarrësit të njiheshin me një terminologji të re, duke ndihmuar në reduktimin e disa prej paragjyqimeve më të rëndomta kundrejt komunitetit LGBT dhe të keqpërdorimit të termave.

Ishte kjo një nga ato eksperiencat unike ku individit ndryshon, rritet, dhe merr me vete një pjesë nga te tjerët... Ishte kjo një nga ato eksperiencat që i dha përgjigje të rinjve që jo vetëm duan të mësojnë rreth tematikës por edhe të kontribuojnë në komunitetin e tyre lokal.

**Holta Dautaj**

## OPINION

### Pritshmëri monogame

Historia personale e një djali nga Stambolli...



"Pa u futur shumë në detaje personale do të përshkruaj lidhjen time e cila tashmë ka përfunduar. Kam qenë me një burrë i cili ishte 40 vjeç dhe vendosëm të martoheshim, Unë i doja fëmijët e tij që i kishte nga martesja e mëparshme me një grua. Më vonë, ky person ndryshoi dhe para martesës kërkoi që unë të kthehesha në vendlindjen time, kështu pa pritun unë e gjeta veten në aeroport vetëm. Po, disa njerëz duan vetëm të bëjnë qejf, por harrojnë që ka disa të tjerë që vuajnë nga kjo..."

*Marrëdhëniet monogame, ashtu siç i njohim quhen marrëdhëniet që bazohen vetëm tek një person përgjatë gjithë jetës!*

**Do doja të ndaja me ju historinë time prej 19 vjeçari ashtu siç e shoh unë.**

Edhe pse unë e njoh veten, dhe e kam pranuar se kam interes ndaj meshkujve, përsëri gjithmonë them që jam gej vetëm me personin me të cilin kam ndër mend të krijoj një lidhje. Po, e di që kjo mund të tingëllojë pak e çuditshme për ndokënd!

**Pse unë e mbështes Monogaminë?**

Kur e kam kuptuar që unë i mbështes lidhjet monogame?

Në fakt, duke qenë se e njoh veten, unë nuk i kam paragjykuar asnjëherë Gay Pride dhe pyesja veten, "Ok Umüt, të gjithë ne duhet të

mbrojmë të drejtat tona, sepse e dimë që njerëzit kanë nevojë për kohë që të pranojnë orientimin tonë seksual dhe të mësohen me të. Por, pse në disa raste të mbrorsh të drejtat e homoseksualëve për ti dalë në mbrojtje disa djemve është e barasvlershme me të dalit lakuriq nëpër rrugë? A do të thotë që të jesh gay të puthesh me njëri - tjetrin dhe të tregosh një trup të bukur? Këto gjëra m'i kanë çorientuar shumë mendimet. Le të shohim këndvështrimin e njerëzve. Disa njerëz janë më mendje hapur dhe mund të mbështesin të drejtat e homoseksualëve. Por është gjithashtu një pjesë tjetër ku njerëzit nuk duan ose nuk mund të na kuptojnë. Sigurisht që nuk ka një arsye të veçantë se pse unë e mbështes Monogaminë. Ashtu siç janë shumë njerëz të ndryshëm në gjithë botën, ka gjithashtu njerëz që mbështesin të kundërtën. Nga eksperiencia ime personale, monogamia

më bën të lumtur dhe më pëlqen ajo. Kjo nuk do të thotë që të kesh një person përgjatë gjithë jetës. Mendoj që në lidhje nëse të dy do të dinin të respektonin njëri tjetrin dhe të besonin tek dashuria, dhe më e rëndësishmja të jeni besnik ndaj partnerit të jetës, mund të arrini në diçka jo vetëm argëtuese por dhe të mahnitshme. Mbase pas kësaj periudhe dramatike për mua, është e domosdoshme të mbështesësh monogaminë...ndoshta.

*Nuk e di nëse do të më pëlqente një person qejfli dhe që ndryshon shpesh lidhjet apo do të preferoja një person që do kujdesej për mua dhe do të ishte aty ku unë do të kisha nevojë...* Thjesht doja të shprehja mendimin tim! personal të dashur miq.

**Gjithë të mirat nga Stambolli.  
UMUT DERE**



## INTERVISTË NË KOMUNITET

### KLEANDRA ZGJEDH SHQIPËRINË

*Në këtë numër kemi zhvilluar një intervistë me një anëtar të komunitetit transgjinnor të sapo kthyer nga Greqia që pëlqen të quhet Kleandra. Ajo na rrëfen në këtë numër disa eksperiencat dhe ndjesi të saj për jetën, shoqërinë dhe modën!*

#### **Përshëndetje, ke shumë pak ditë që jeni kthyer nga Greqia, a mund të na flisni për kohën e kaluar atje?**

Vitet e mia në Greqi mund ti quaj si vite të arta. Kam kaluar shumë mirë atje, me pak fjalë jetë e lirë dhe pa paragjykime. Ambianti atje të pranon ashtu siç je.

#### **Pa paragjykime?**

Po. Paragjykimi.... ( qesh ) atje nuk ekziston si fjalë, sepse unë nuk jam ndier e paragjykuar. Komplet e kundërta po më ndodh në Shqipëri, këtu duket sikur asgjë nuk ndryshon në këtë aspekt. Krahasimi mes Shqipërisë dhe Greqisë është si nata me ditën përsa i përket komunitetit transgjinnor.

#### **Mund të më tregoni nga kush ndiheni i paragjykuar këtu?**

Më ke prekur atje ku mua më pëlqen të flas. Këtu ndihem e paragjykuar në të gjitha aspektet dhe nga gjithë shoqëria. Imagjinojeni, unë paragjykohej nga komuniteti LGBT e jo më nga të tjerët të cilët as nuk kanë marrë ndonjëherë iniciativën të na njohin!

#### **A mund të më tregoni një rast kur je ndier e paragjykuar nga komuniteti LGBT?**

Ka shumë raste të tilla s`di se cilën të tregoj, gjithsesi më e freskëta është në një lokal këtu në Tiranë, një grup që unë i njoh që janë të komunitetit LGBT kthehen nga unë dhe më drejtohen me një fjalor banal, unë reagoja vetëm me një nën buzëqeshje dhe ika. Ky ishte vetëm një ndër rastet e fundit sepse takimi me situata paragjykuuese ndaj meje janë bërë të zakonshme, kjo sepse

nga natyra jam tip i hapur dhe vetvetja, këtë e tregojnë dhe rrobat femërore që pëlqej të vesh.

#### **Po më thoni me një pasion të madh që pëlqeni të vishni rrobat femërore, janë këto rroba që vishni më së shumti?**


Po të shohësh në të gjithë garderobën time shumë më shumë do të gjeësh rroba femrash sesa rroba meshkujsh. Mua gjithmonë me ka pëlqyer të vishem me rroba femrash, sepse me to ndjehem shumë më rehat dhe më vetvetja sesa me rroba meshkujsh.

#### **Shoqëria dhe miqtë tuaj diskutojnë shpesh për mënyrën tuaj të veshjes, ata shprehin se ju visheni shumë bukur, gjithashtu ju diskutoni rreth rrobave tuaja të preferuara dhe modës. A mund të na e përshkruani veshjen tuaj të preferuar?**

Gjëja që mua më pëlqen shumë, po shumë ama, është një fustan në formën e flamurit Shqiptar, pak a shumë si ai i Aurela Gaces tek festivali eUropan vetëm se i imi është kuq e zi. Pastaj kam edhe një fustan komplet të zi të derdhur sipas trupit që po ashtu e kam të preferuar. Të them të drejtën kam jashtë mase shumë dhe nuk di se kujt ti vë gishtin sepse për mua të gjithë kanë nga një gjë të veçantë.

#### **Mos është një nga këto fustanet që do të veshësh për paradën e gay-ve që do të organizohet në Greqi muajin tjetër?**

Të gjithë po më pyesin këto ditë në ambasadën PINK për këtë gjë, atë fustan që kam menduar ta vesh atë ditë do ta shihni vetëm atë ditë. Dëshiroj t`jua lë pak enigmë sepse e kam rezervuar vetëm për atë ditë.



*"Mua më pëlqejnë jashtë mase rrobat ekstravagante dhe ngjyrat e çelura sepse, janë tipike ngjyrat që eksitojnë meshkujt. Këto rroba dominojnë dhe në garderobën time."*



## KËSHILLA

### Si t'u flasësh fëmijëve për homoseksualitetin?

*Filloni duke pyetur fëmijën nëse e kuptojnë se çfarë do të thotë fjala "gay". Nëse dëgjoni fëmijën që përdor këtë fjalë ose nëse e dëgjoni në televizor diskutoheni me të.*

**Shpjegojuni që një homoseksual(një person gay) është dikush që ka ndjenja emotive dhe seksuale ndaj personave të të njejtit seks. Dhe kjo është e vetmja gjë që e bën një person të jetë gay.**

Shpjegojuni që nuk mund të thuash për dikë që është gay vetem nga mënyra sesi ata sillen, disa meshkuj kanë disa sjellje femërore ndërsa disa femra kanë disa sjellje mashkullore por kjo nuk do të thotë që janë gay .

Shpjegojuni sesi disa njerëz e përdorin termin. Fëmijet tuaj duhet të kuptojnë se fëmijet e tjerë mund t'i

thonë se disa sjellje janë shenja homoseksualiteti por e kanë gabim. P.sh. te veshesh mbathje te shkurtra (brek) nuk të bën të jesh gay, dhe nuk të bën të kesh probleme me shqiptimin, meshkuj me tonalitet të lartë zëri, femra me tonalitet të ulët zëri, të përqafosh një person të të njejtit seks, të shohësh një person të të njejtit seks lakuriq, të bësh dush në dhomat e zhveshjes, të dëgjosh siglat e shfaqeve, etj. Kjo listë vazhdon në pafundësi.

Ata duhet të dinë se është normale për fëmijët të jenë kurjoze për trupat e tyre dhe të njerëzve të tjerë të të njejtit seks. Kjo nuk do të thotë të jesh homoseksual.

Fëmijët duhet të dinë se është e zakonshme të kenë eksperiencë seksuale në adoleshencë me miq të të njejtit seks, kjo s'do të thotë që do të jenë gay kur të jenë në moshë më të pjekur.



Mos tregimi i interesit ndaj seksit të kundërt nuk do të thotë që dikush është gay. Disa njerëz thjesht nuk kanë ose nuk e shprehin hapur interesin. Nuk duhet kurrë të humbasësh virgjerinë për ti vërtetuar vetes ose të tjerëve që nuk je gay. Disa persona e kanë bërë me të vërtete këtë gjë.

- Thuajini fëmijëve që nuk duhet kurrë të arrijnë në konkluzione për orjentimin seksual të dikujt. Kjo gjë mund të lëndojë dike me të vërtete.
- Mos harroni të shpjegoni që lakuriqesia në dhomat e zhveshjes nuk ka të bëjë fare me homoseksualitetin. Në këtë mënyrë fëmija juaj nuk do të ndihet në siklet në dhomat e zhveshjes kur te rriten.
- Thuajini fëmijëve se nëse dikush mohon të jetë homoseksual duhet t'i besoni.
- Mësojini fëmijëve diferencën midis një shoqërie intime dhe romances. Dy shok/ shoqe mund të duhen pa qënë gay/ lezbike. Është e rëndësishme që t'i kaloni dhe një herë keshillat e mësipërme, nëse fëmija juaj ka disa nga sjelljet e mësipërme ka mundësi që të kenë një krizë identiteti seksual me vonë.



## NDËRKOMBËTARE

### Rënia e perandorisë Romake; "Shkaktuar nga homoseksualët"

Një Drejtues akademik italian po përballet me kërkesa të vazhdueshme për të dhënë dorëheqjen pasi ai ka deklaruar se rënia e Romës ka ardhur si shkak i homoseksualitetit.

Profesor Roberto De Mattei, Zëdhënës Kryetar i qendrës kombëtare në Itali për hulumtime i cili është gjithashtu një katolik i devotshëm, në radio Maria në rrjetin e lajmeve për fenë Prof De Mattei, 63 vjeçar shprehet:

"Shkatërrimi i pe-randorisë romake dhe ardhja e Barbarëve ishte shkak i përhapjes së homoseksualitetit. Kolonia Romake e Kartagjenas ishte një parajsë për Homoseksualët, prania jo normale e disave bënte të devijonin dhe të tjerët".

Profesor Roberto De Mattei i ka bazuar komentet e autorit të shekullit të pestë pas Krishtit Salviano di Marsiglia. Ai shtoi: ""Pushtimi i barbarëve (në Romë) ka qenë parë si një ndëshkim i transformimit negativ të moralit. Është më se e njohur se burrat si femra dhe homoseksualët nuk kanë vend në mbretërinë e zotit. Homoseksualiteti nuk gjendej tek barbarët, dhe kjo tregonte se drejtësia e zotit vjen me kohën dhe jo vetëm në fund.

Historianë, grupet që punojnë për të drejtat e ho-



moseksualëve dhe politikanë shprehin zemërim ndaj disa thirrjeve të tij. Paola Concia, MP për pozicionin e majtë demokratik, thotë: "Kam paraqitur një thirrje urgjente për Ministren e Edukimit Maria Stella Gelmini, që të ndërhyjë patjetër.

Prof De Mattei ishte caktuar në këtë post tre vjet më parë dhe ishte një mik i ngushtë i Ministres së Edukimit dhe gjithashtu i Kryeministrit Silvio Berlusconi, ku një herë tha një shprehje të famshme: "Më mirë të dashurosh femrat sesa të jesh homoseksual."

Emilio Gabba një ndriçues i historisë së lashtë romake tha: "është më se e pamundur që të mendojmë se homoseksualët janë ata që e çuan në rënje perandorinë Romake."

Profesor Lellia Craço Ruggini një tjetër ekspert i historisë Romake nga Uni-

versitetit i Turin shprehet: "Nuk ka ndonjë të dhënë se në Romë ka pasur një numër të lartë të homoseksualëve. Kështu që Roma nuk ka rënë për shkak të tyre.

Gjithsesi kërkimet nga historianë të tjerë duhet ta shohin homoseksualitetin si diçka që ka ekzistuar realisht në Romën e Lashtë.

Eksperti i shekullit të 17-të, Edward Gibbon, shkroi në mënyrë famoze se: "nga 15 perandorët vetëm Claudius kishte shenja dashurie plotësisht të sakta."

Homoseksualiteti është portretizuar dhe shprehur gjerësisht nëpërmjet artit gjatë periudhës së perandorisë Romake dhe është parë gjerësisht si një sjellje e pranueshme 2000 vjet më parë.

NICK PISA

# MANIFESTI PËR TË DREJTAT E KOMUNITETIT LGBT NË SHQIPËRI!

## 1. PARANDALO DISKRIMINIMIN!

Diskriminimi dhe paragjykimi mbetet një nga problemet kryesore me të cilat përballlet komuniteti në familje, shkollë, shoqëri, vendin e punës etj. Për këtë arsye komuniteti rekomandon:

- Zbatimi i plotë i Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
- Respektimi dhe Promovimi i të Drejtave të Komunitetit nëpërmjet:
- Caktimi i pikave të kontaktit në Bashki për çështjet LGBT;
- Realizimi i fushatave lokale ndërgjegjësuese kundër diskriminimit;
- Miratimi i politikave të brendshme në Bashki për parandalimin dhe eliminimin e diskriminimit;
- Realizimi i aktiviteteve të përbashkëta mes Bashkive dhe komunitetit;

## 2. SIGURI!

Mungesa e sigurisë dhe pranimi lehtësisht të të qenit homoseksual, lesbike, biseksual dhe transeksual nga shoqëria, bëjnë që komuniteti të ndihet i pambrojtur dhe të privohet nga të drejtat, që si qytetarë të këtij vendi iu takojnë me ligj. Për këtë arsye rekomandohet:

- Trajnimi i stafeve të Bashkive dhe Komunave për të njohur të drejtat e komunitetit LGBT;
- Trainimi i forcave policore në nivel lokal për t'u aftësuar në respektimin e të drejtave të komunitetit dhe për të garantuar mbrojtjen e tyre.
- Vendosja e një numri telefoni falas për çdo rast emergjence;

## 3. SHËRBIME SOCIALE DHE PËRKUJDESJE!

Personat LGBT hasin një mungesë të theksuar apo inefiçencë të shërbimeve sociale. Shërbimet sociale për komunitetin ndikojnë në cilësinë e jetës dhe mirëqenies së tyre. Për këtë arsye rekomandohet:

- Ofrimi i shërbimeve psiko-sociale dhe shërbimeve mbështetëse për komunitetin me fokus të veçantë komunitetin transgjjinor;
- Hapja e Strehëzave për komunitetin në nevojë , Qendrave të Këshillimit, Klubeve sociale, etj;
- Buxhetimi me pjesmarrje dhe në konsultim me komunitetin pranë çdo Bashkie;

## 4. STREHIMI!

Një nga problemet më të mëdha për komunitetin është strehimi, që prek personat që dëbohen nga familja dhe veçanërisht komunitetin transgjjinor. Për këtë komuniteti rekomandon:

- T'i jepet përparësi politikave të strehimit për komunitetin, duke promovuar strehimin e sigurt të personave në situata emergjence, nga skema e strehimit pranë Bashkive;
- Sigurimi i strehimit të për-kohshëm dhe të përhershëm për komunitetin transgjjinor, sidomos në Tiranë;

## 5. PUNËSIM!

Një problem esencial që ndikon në garantimin e mirëqenies sociale të komunitetit LGBT është papunësia. Punësimi i komunitetit forcon mirëqenien e tyre dhe të familjeve. Për këtë arsye rekomandohet:

- Shmangia e diskriminimit në punësim duke ofruar mundësi të barabarta për komunitetin;
- Të shikohet me përparësi punësimi i komunitetit transgjjinor; Të nxitet dhe të mbështeten nismat e vetë-punësimit të komunitetit LGBT.

**TË GJITHË NJERËZIT KANË TË DREJTA TË BARABARTA!**

**UNË DASHUROJ SI  
GJITHË TË TJERËT!**



**17 MAJ**

**Dita Ndërkombëtare Kundër Homofobisë**



Kingdom of the Netherlands



Për komente, sugjerime apo pyetje na kontaktoni në [info@pinkembassy.al](mailto:info@pinkembassy.al). Për më shumë vizitoni [www.pinkembassy.al](http://www.pinkembassy.al)